



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

LEGJISLATURA V
Sesioni vjeshtor

Komisioni për Bujqësi, Pylltari, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor
Mbledhja nr. 46
Prishtinë, më 7.10.2016, ora 13:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla N-302

PROCESVERBAL

Në mbledhje morën pjesë: Duda Balje, Adem Salihaj, Sërgjan Popoviq, Salih Salihu, Time Kadrijaj, Haxhi Shala dhe Shaip Muja.

Mungoi : Emilija Redzeqi, Murat Hoxha.

Të ftuar dhe pjesëmarrës tjerë, sipas listës së nënshkrimeve.

Stafi mbështetës i Komisionit: Bajram Badivuku dhe Ylber Sherifi.

Mbledhjen e kryesoi, **Duda Balje**, kryetare e Komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky rend i ditës:

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**
- 2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së datës 29.9.2016;**
- 3. Shqyrtimi i projektligjit për performancën energjetike;**
- 4. Të ndryshme.**

Kryesuesja **Duda Balje**, konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe hapi mbledhjen.

1. Miratimi i rendit të ditës;

Rendi i ditës për këtë mbledhje u miratua pa vërejtje.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së datës 29.9.2016;

Procesverbali i mbledhjes të datës 29.9.2016 u kërkua nga Adem Salihaj të jetë më gjithëpërfshirës dhe të plotësohet.

3. Shqyrtimi për leximin e dytë të projektligjit për performancën energjetike në ndërtesa

Duda Balje, kryetare, falënderoi pjesëmarrësit dhe parashtrroi para komisionit punën që është bërë në grupin punues rreth këtij projektligji. Para se të votohen propozimet e grupit punues u debatuan çështjet e gjobave në këtë ligj për çka zyrtarët e Ministrisë së mjedisit sugjeruan që ky ligj është më mirë të mbetet pa ato dispozita ngase edhe shtetet e rajonit nuk i kanë por janë të rregulluara me mekanizma tjera detyruese. Megjithatë sqarime u kërkuan nga **Adem Salihaj** i cili pyeti nëse nuk i përmbahen kritereve në lidhje me performancën e energjisë me çka gjobiten investitorët, **Salih Salihu** pyeti për shtëpitë e vogla dhe në cilin fazë kërkohet kjo certifikatë dhe **Shaip Muja** për të cilat sqarime u kujdesën zyrtarët e ministrisë duke konstatuar se me këtë ligj transponohen një pjesë e direktivës evropiane që ceket, ndërsa në pyetjen e parashtruar nga z. Adem thanë se kjo rregullohet me Ligjin e ndërtimit ku në Nenin 27 parashihen tri kritere bazë : projekti, huthja e mbeturinave dhe trajtimi me masat për kursimin e energjisë, ndaj komuna nëse i kryen obligimet si duhet atëherë mund të mos figurojnë gjobat në këtë ligj, me çka edhe do të krijohej një politikë edukative, esenca e këtij ligji janë : izolimi i kulmit, fasada e jashtme dhe temelit, kurse në kërkesën e **Time Kadrijaj** që të përcaktohet me një amendament që kjo problematikë do të zgjedhet me udhëzim administrativ, zyrtari i ministrisë shtoi se nuk ka nevojë ngase ajo nënkuptohet kur është në pyetje UA. Në vazhdim u votuan Amendamentet dhe u përcjellën tek komisionet e përhershme si vijon :

Amendamenti 1

Nenit 1, Paragrafi 2, në reshtin e 1 pas fjalës “është” shtohet “pjesërisht”.

Amendamenti 2

Neni 3, nënparagrafi 1.17, në reshtin e 4 fjala “ajri” zëvendësohet me “era”.

Amendamenti 3

Neni 6, paragrafi 1, në fund, në vend të “Këto kërkesa të” zëvendësohet me “të cilat”.

Neni 6, paragrafi 3, nënparagrafi 3.1, në reshtin e 3 në vend të fjalës “energjinë” të shënohet “ndërtimin, rindërtimin apo rinovimin”.

Neni 6, paragrafi 3, nënparagrafi 3.2 , pas fjalës “nënligjor” shtohet “të nxjerr nga MMPH”.

Amendamenti 4

Neni 8, Paragrafi 2 riformulohet : 2. Plani dorëzohet në Sekretariatit e Komunitetit të Energjisë si pjesë e Planit kombëtar të veprimit për efikasitetin e energjisë në të cilën është përfshirë edhe raporti i progresit për zbatimin e këtij plani çdo 3 (tri) vite.

Amendamenti 5

Neni 9, paragrafi 2 riformulohet : Për një ndërtesë , sipërfaqja e përdorshme e së cilës tejkalon 500 m², e cila përdoret nga një autoritet publik e cila vizitohet nga publiku, CPE duhet të ekspozohet në një vend të dukshëm që shihet lehtë nga publiku.

Amendamenti 6

Neni 11, Paragrafi 9 riformulohet :

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor ne koordinim me Ministrinë e Zhvillimit Ekonomik nxjerr akt nënligjor që përcakton specifikimin e detajuar të gjitha elementeve të procedurave të inspektimit .

Amendamenti 7

Neni 12, paragrafi 3, nënparagrafi 3.2 riformulohet : ti përmbahet MKK-së sipas Nenit 5 të këtij ligji për përgatitjen e CPE-ve.

Amendamenti 8

Neni 13, nënparagrafi 2.2 dhe 2.3 në vend të fjalës “pika” shënohet “nënparagrafi”.

Amendamenti 9

Neni 14, paragrafi 1, nënparagrafi 1.6, në fund pas fjalës “sistemit” shtohet “të paraparë sipas Nenit 6 të këtij ligji”, ndërsa “të Nenit 6” fshihet.

Amendamenti 10

Fshihet Neni 15 dhe 16.

Amendamenti 11

Neni 17, në paragrafin 2 të përmirësohet dhe të shënohet **Agjencia e Kosovës për efikasitetin e energjisë.**

5.Të ndryshme.

Kryesuesja sugjeroi dhe komisioni u pajtua si vijon :

- caktohet mbledhja e komisionit për datën 12 për Projektligjin e përgatitur nga Agjencia e komplekseve memoriale dhe për çështjen e Hades,
- kandidatët **Bashkim Halabaku dhe Xhelal Selmani** dërgohen mbledhjes plenare për votim për zëvendës drejtor në ARRU, ndërsa **Arsim Rashiti dhe Goran Arsiq** dërgohen mbledhjes plenare për votim për Kryesues të komisionit shqyrtues në ARRU. Ankesa e kandidatit që është ankuar për procedim jo të rregullt konstatohet si jo e bazuar ngase stafi administratës ka konstatuar procedimin ligjor dhe brenda afatit nga komisioni, por ky kandidat nëse ankohet më tutje në zgjedhjen e kandidatëve nga Kuvendi, atëherë mund ti dërgohet përgjigja.
- Komisioni pajtohet që vizita në autoritetin rregullator për ujëra në Bullgari me agjendën e propozuar nga zyrtarja në Bullgari sipas imejllit, të kryhet më 16,17,18 nëntor 2016 duke përmbushur kërkesën e ARRU që delegacioni të jetë 5 antarësh : **Duda Balje, Salih Salihu, Haxhi Shala, Murat Hoxha dhe Bajram Badivuku** simbas parimit udhëtojnë ata që nuk kanë udhëtuar.

Mbledhja përfundoi në orën 14:00.

E përgatiti: Stafi mbështetës i Komisionit.

Kryetarja e Komisionit,
Duda Balje